vegjël boys

vajza e vogël the small girl

vajzat e vogla the small girls

qilimi i zi the black
carpet

qilimat e zinj the black
carpets

makina e zezë the black car

makinat e the black
zeza cars

(një) djalë i madh	a big boy	djali i madh	the big boy
(disa) djem të mëdhenj	some big boys	djemtë e mëdhenj	the big boys
(një) shtëpi e madhe	a big house	shtëpia e madhe	the big house
(disa) shtëpi të mëdha	some big houses	shtëpitë e mëdha	the big houses
(një) libër i kuq	a red book	libri i kuq	the red book
(disa) libra të kuq	some red books	librat e kuq	the red books
(një) shtëpi e kuqe	a red house	shtëpia e kuqe	the red house
(disa) shtëpi të kuqe	some red houses	shtëpitë e kuqe	the red houses

Predicative Class 2 adjectives: Plural forms

When used predicatively, plural Class 2 adjectives always bear the adjectival article **të** with definite or indefinite subjects.

Studentët janë të mirë.

The students are good.

Makinat janë të zeza.

The cars are black.

Disa djem janë shumë të rinj.

Some boys are very young.

Disa dhoma janë të këqija.

Some rooms are bad.



Exercise 5

Complete the following sentences with the appropriate forms of the noun and the adjective given in parentheses. Then change the sentences into the plural.

- 1 Ekonomisti i mirë (The good economist) **punon shumë.**
Ekonomistët e mirë punojnë shumë.
- 2 _____ (The small brother) **jeton në Itali.**
_____.
- 3 _____ (The bad male student) **nuk mëson shumë.** _____.
- 4 _____ (The big girl) **banon në Angli.**
_____.
- 5 _____ (The new female student) **është e mirë.**
_____.

Exercise 6



Change the following sentences into the plural.

- 1 **Çmimi është i arsyeshëm.** Çmimet janë të arsyeshme.
- 2 **Varësja është e bukur.**
- 3 **Qilimi është i shtrenjtë.**
- 4 **Unaza është e veçantë.**
- 5 **Byzylyku është i mirë.**
- 6 **Shtëpia është e madhe.**
- 7 **Makina është e zezë.**
- 8 **Djali i vogël është i keq.**
- 9 **Shtëpia e kuqe është e madhe.**
- 10 **Libri i kuq është i madh.**

Exercise 7



Translate the following sentences.

- 1 We have beautiful rings and necklaces.
- 2 How much is the ring?
- 3 The rings have different prices.
- 4 The carpets are expensive.
- 5 The traditional dresses are beautiful.
- 6 How much are the black rings?

Unit Five

Apartamenti im

My apartment



In this unit you will learn about:

- modifying accusative indefinite nouns
- **më pëlqen** 'to like'
- describing your house
- modifying accusative definite nouns



Dialogue 1



Apartamenti im (CD1; 40)

Sofia is visiting Klara's apartment for the first time.

KLARA Sofia, ky është apartamenti im. Apartamenti nuk është shumë i madh, por është shumë komod.

SOFIA Paske një apartament shumë të bukur, Klara! Më pëlqen shumë.

KLARA Korridor i është pak i ngushtë, por është funksional. Kurse kjo është soxhornoja.¹ Soxhornoja është e madhe dhe ka shumë dritë.

SOFIA Sa dritare ka soxhornoja?

KLARA Ka dy dritare të mëdha. Kjo këtu majtas, është një kuzhinë e vogël gatimi. Këtu kemi një tavolinë të vogël me katër karrige dhe një divan të madh, sepse në darkë rrimë këtu zakonisht.

¹ **Soxhorno** 'living room' is a word borrowed from Italian that has started to be used recently.

SOFIA Sa dhoma gjumi keni?

KLARA Kemi dy dhoma gjumi. Dhomat janë të vogla, por kanë ballkone. Ballkonet janë shumë të bukura.

SOFIA Sa banja keni?

KLARA Kemi dy banja jo shumë të mëdha.² Atje në fund kemi dhe një depo të vogël ku mbajmë gjëra të ndryshme.

KLARA *Sofia, this is my apartment. My apartment is not very big, but it is very comfortable.*

SOFIA *You have a very beautiful apartment, Klara! I like it a lot!*

KLARA *The corridor is a little narrow, but it is functional. And this is the living room. The living room is big; it gets a lot of light.*

SOFIA *How many windows does the living room have?*

KLARA *It has two big windows. Here on the left is a small kitchen. Here we have a small table with four chairs and a big sofa, because we usually spend time here in the evening.*

SOFIA *How many bedrooms do you have?*

KLARA *We have two bedrooms. The bedrooms are small, but they have balconies. The balconies are very beautiful.*

SOFIA *How many bathrooms do you have?*

KLARA *We have two bathrooms, not too big. There at the end we have a storage room where we keep different things.*

Vocabulary



apartament , -i, -e	apartment
apartamenti im	my apartment
ballkon , -i, -e	balcony
banj/ë , -a, -a	bathroom
depo , -ja, -	storage room, depot
divan , -i, -e	sofa
drit/ë , -a, -ë	light
dritar/e , -ja, -e	window
dhomë gjumi	bedroom

² In colloquial Albanian you will also hear **banjo**: **dy banjo jo shumë të mëdha**.

fund , -i	end, bottom
në fund	at the end
funksional , -e	functional
gjë , -ja, -ra	thing
karrig/e , -ia, -e	chair
kjo	this (fem)
komod , -e	comfortable
korridor , -i, -e	hall, hallway
kuzhin/ë , -a, -a	sitting room
kuzhinë gatimi	kitchen
ky	this (masc)
mbaj	to keep
më pëlqen	I like it
i ndrysh/ëm , e -me	different, various
i,e ngushtë	narrow
paske ³	you have! (expressing surprise)
rri	to stay
soxhorno , -ja, -	living room
tavolin/ë , ⁴ -a, -a	table
zakonisht	usually



Language points

Accusative indefinite nouns and Class 2 adjectives: Singular forms

In Unit 4, we learned that Class 2 adjectives always take the adjectival article **i** or **e** when modifying an indefinite nominative noun.

Ky është një apartament i bukur. This is a beautiful apartment.

Kjo është një shtëpi e bukur. This is a beautiful house.

³ This form is in the admiring mood. You will learn more about the admiring mood in Unit 15.

⁴ Also: **tryezë**.

Direct objects typically appear in the accusative case. When a Class 2 adjective modifies an indefinite direct object, the adjectival article is **të**. The adjective itself remains unchanged.

Unë kam një apartament të bukur. I have a beautiful apartment.

Unë kam një shtëpi të bukur. I have a beautiful house.

The following chart summarizes the different forms of a Class 2 adjective when it modifies an indefinite singular noun in the nominative case (subject position) and in the accusative case (direct object position). In the singular form neither the noun nor the adjective change; only the adjectival article changes.

	<i>Masculine</i>	<i>Feminine</i>
Nominative	një apartament i bukur	një shtëpi e bukur
Accusative	një apartament të bukur	një shtëpi të bukur

Accusative indefinite nouns and Class 2 adjectives: Plural forms

When a Class 2 adjective modifies an indefinite plural subject, the adjectival article is always **të**.

The adjective takes a final **-a** if the noun is feminine plural.

Disa studentë të mirë flasin shqip.
Some good students (masc) speak Albanian.

Disa studente të mira flasin shqip.
Some good students (fem) speak Albanian.

The same forms of the adjective and adjectival article are used with (accusative) direct objects:

Profesori ka disa studentë të mirë.
The professor has some good students (masc).

Profesori ka disa studente të mira.
The professor has some good students (fem).

We saw in Unit 2 that the preposition **në** 'in, at' also requires the accusative case. The same adjectival articles are used in this instance.

Banoj në një apartament të bukur.

I live in a beautiful apartment.

Gëzimi banon në një shtëpi të bukur.

Gëzim lives in a beautiful house.

The following chart summarizes the indefinite forms studied so far.

	<i>Masculine singular</i>	<i>Masculine plural</i>	<i>Feminine singular</i>	<i>Feminine plural</i>
Nominative	(një) student i mirë	(disa) studentë të mirë	(një) studente e mirë	(disa) studente të mira
Accusative	(një) student të mirë	(disa) studentë të mirë	(një) studente të mirë	(disa) studente të mira

Më pëlqen

Më pëlqen means 'I like' (literally: (it) is pleasing to me). Likes or dislikes can be expressed using this structure. What you like appears in the definite form and in the nominative case, as it is the subject of this construction, and, consequently, it must agree with the verb. When what you like is plural, the verb will be in the plural form too. The subject typically follows the verb in these constructions. The definite form is used even if the subject is indefinite (or generic, i.e. it refers to a class of objects) in English.

Më pëlqen **akullorja**.

I like ice cream.

Më pëlqejnë **mollët**.

I like apples.

Më pëlqen **apartamenti**.

I like the apartment.

Nuk më pëlqen **apartamenti**.

I don't like the apartment.

Më pëlqejnë **apartamentet**.

I like the apartments.

Më pëlqejnë **disa apartamente**.

I like some apartments.

To ask whether someone likes something use **të pëlqen/pëlqejnë** (informal) or **ju pëlqen/pëlqejnë** (formal). The use of the interrogative particle **a** in front of the sentence is optional.

Të pëlqen shtëpia?

Do you like the house?

A ju pëlqen libri?

Do you like the book?

A të pëlqejnë shtëpitë?

Do you like the houses?

Ju pëlqejnë librat?

Do you like the books?

Exercise 1



Translate the words in parentheses. Then change the sentences into the plural using the numeral **dy** 'two'.

1 **Ti ke** _____ një apartament të vogël _____ (a small apartment).

Ti ke dy apartamente të vogla.

2 **Këtu ke** _____ (a red table).

3 **Ai ka** _____ (a black sofa).

4 **Ajo do** _____ (a big house).

5 **Vajza shikon** _____ (a comfortable apartment).

Exercise 2



Ask whether your partner likes the words in parentheses. Then answer the questions. Be formal or informal as stated. Keep the number (singular or plural) of the nouns as indicated.

1 **Të pëlqen kafeja** ? (**kafe**, informal) **Po, më pëlqen kafeja.**

2 _____ ? (**birrë**, informal) _____

3 _____ ? (**muzikë**, formal) _____

4 _____ ? (**dhoma**, formal) _____

5 _____ ? (**mësuese**, informal) _____

Exercise 3



Translate the following sentences.

1 The apartment is small but very comfortable.

2 I like (female) teachers. I don't like (male) teachers.

3 I like the hallway. It is functional and it gets a lot of light.

4 We have a small table with four small chairs.

5 We have two large bedrooms.



Dialogue 2



Klara po kërkon një apartament me qira (CD1; 42)

Eva and Ingrid are talking about Klara, who is looking to rent an apartment.

-
- EVA Ingrid, me kë po flet në telefon?
- INGRIDI Po flas me Klarën. Klara po kërkon një apartament me qira.
- EVA Çfarë apartamenti do Klara?
- INGRIDI Do një apartament të vogël, një dhomë dhe një kuzhinë, këtu afër.
- EVA Ingrid, ka disa apartamente të lira në pallatin e ri, këtu përballë.
- INGRIDI Janë shumë të shtrenjta?
- EVA Nuk besoj se janë shumë të shtrenjta. Janë apartamente të pamobiluara.
- INGRIDI Në çfarë kati janë?
- EVA Janë në katin e dytë ose në katin e tretë.
- INGRIDI Shumë mirë. Faleminderit Eva!
-
- EVA *Ingrid, who are you talking to on the phone?*
- INGRIDI *I am talking to Klara. Klara is looking for an apartment for rent.*
- EVA *What kind of apartment does Klara want?*
- INGRIDI *She wants a small apartment, (with) one bedroom and a kitchen, near here.*
- EVA *Ingrid, there are several available apartments in the new building here in front.*
- INGRIDI *Are they very expensive?*
- EVA *I don't think they are very expensive. They are unfurnished apartments.*
- INGRIDI *What floor are they on?*
- EVA *They are on the second floor or on the third floor.*
- INGRIDI *Very well. Thank you Eva!*
-

Vocabulary



kë	whom
kërkoj	to search, to look for
qira, -ja, -	rent
me qira	for rent
pallat, -i, -e	building, palace, condominium
i, e pamobiluar	unfurnished
përballë	opposite
i, e shtrenjtë	expensive

Language points



Accusative definite nouns

In Dialogue 2, you encountered the following sentences:

Po flas në telefon me Klarën.

I am talking on the phone with Klara.

Ka disa apartamente të lira në pallatin e ri.

There are several available apartments in the new building.

The ending **-n** is the marker for the singular accusative case both for masculine and feminine nouns.

To form the accusative case of definite masculine singular nouns, add **-n** to the definite singular nominative form.

student → **student-i** → **student-i-n**

the student (masc)

shok → **shok-u** → **shok-u-n**

the friend (masc)

Po shikoj studentin.

I am watching the student (masc).

Po flas me shokun.

I am speaking with the friend (masc).

To form the accusative case of definite feminine singular nouns, add **-n** to the indefinite singular form.

vajzë → vajzë-n	the girl (acc)
shoqe → shoqe-n	the friend (fem, acc)
Po shikoj vajzën.	I am speaking with the daughter (fem, acc).
Po flas me shoqen.	I am speaking with the friend (fem, acc).

For feminine nouns that end in a stressed vowel add **-në**.

shtëpi → shtëpi-në	the house (acc)
Po shikoj shtëpinë.	I am seeing the house.

For proper nouns that end in **-a**, change the **-a** into **-ën**.

Teuta → Teut-ën	
Vizitoj Teutën çdo javë.	I visit Teuta every week.

To form the definite plural accusative, use the same form as the definite plural nominative; simply add **-t** to the corresponding plural form of both masculine and feminine nouns.

Studentët janë këtu.	The students (masc, nom) are here.
Po shikoj studentët.	I see the students (masc, acc).
Vajzat janë këtu.	The girls (fem, nom) are here.
Po shikoj vajzat.	I see the girls (fem, acc).

The following chart summarizes the definite nominative and accusative forms studied so far.

	<i>Masculine singular</i>	<i>Masculine plural</i>	<i>Feminine singular</i>	<i>Feminine plural</i>
Nominative	studenti	studentët	studentja	studentet
Accusative	studentin	studentët	studenten	studentet

Accusative definite nouns and Class 2 adjectives: Singular

Accusative indefinite singular nouns always take the adjectival article **të**.

Unë kam një apartament të bukur.

I have a beautiful apartment.

Unë kam një shtëpi të bukur.

I have a beautiful house.

Accusative definite singular nouns always take the adjectival article **e**.

Unë shikoj apartamentin e bukur.

I see the beautiful apartment.

Unë shikoj shtëpinë e bukur.

I see the beautiful house.

Accusative definite nouns and Class 2 adjectives: Plural

When used with plural definite accusative nouns, adjectives have the same form used with definite nominative nouns.

Studentët e mirë flasin shqip.

The good students (masc) speak Albanian.

Studentet e mira flasin shqip.

The good students (fem) speak Albanian.

Unë flas me studentët e mirë.

I speak with the good students (masc).

Unë flas me studentët e mira.

I speak with the good students (fem).

The following chart summarizes the definite forms studied so far.

	<i>Masculine singular</i>	<i>Masculine plural</i>	<i>Feminine singular</i>	<i>Feminine plural</i>
Nominative	studenti i mirë	studentët e mirë	studentja e mirë	studentet e mira
Accusative	studentin e mirë	studentët e mirë	studenten e mirë	studentet e mira

The following chart summarizes the indefinite forms studied so far.

	<i>Masculine singular</i>	<i>Masculine plural</i>	<i>Feminine singular</i>	<i>Feminine plural</i>
Nominative	një student i mirë	disa studentë të mirë	një studente e mirë	disa studente të mira
Accusative	një student të mirë	disa studentë të mirë	një studente të mirë	disa studente të mira

Prepositions used with the accusative case

The following prepositions require an accusative noun:

për 'for'	Po flas për apartamentin e ri.	I am speaking about the new apartment.
me 'with'	Po flas me Klarën.	I am speaking with Klara.
në 'in, at'	Ata banojnë në apartamentin e ri.	They live in the new apartment.
pa 'without'	Ajo shkon në shkollë pa shokën.	She goes to school without (her) friend.
mbi 'on'	Libri është mbi tavolinën e re.	The book is on the new table.
nën 'under'	Libri është nën tavolinën e re.	The book is under the new table.

When a noun is used by itself after a preposition, use the indefinite form, even if it is expressed as a definite form in English. If the noun is modified by an adjective, then use the definite form.

Libri është mbi tavolinë.

The book is on the table.

Libri është mbi tavolinën e re.

The book is on the new table.

Ata po shkojnë në shkollë.

They are going to (the) school.

Ata po shkojnë në shkollën e re.

They are going to the new school.

With proper nouns, always use the definite form, both for masculine and feminine nouns.

Shkoj pa Gëzimin. I go without Gëzim.
Shkojmë pa Teutën. We go without Teuta.

Ordinal numbers

In Dialogue 2, you encountered this sentence:

Janë në katin e dytë ose në katin e tretë.
 They are on the second or on the third floor.

These are ordinal numbers. Ordinal numbers are used as adjectives (hence they modify a noun) and always bear an adjectival article (see Unit 4). Numbers higher than five keep the same form as the corresponding cardinal number, but the first five ordinal numbers must be memorized.

<i>Cardinal</i>	<i>Ordinal</i>	<i>Cardinal</i>	<i>Ordinal</i>
1 një	i,e parë	6 gjashtë	i,e gjashtë
2 dy	i,e dytë	7 shtatë	i,e shtatë
3 tre	i,e tretë	8 tetë	i,e tetë
4 katër	i,e katërt	9 nëntë	i,e nëntë
5 pesë	i,e pestë	10 dhjetë	i,e dhjetë

<i>Cardinal</i>	<i>Ordinal</i>
11 njëmbëdhjetë	i,e njëmbëdhjetë
12 dymbëdhjetë	i,e dymbëdhjetë
13 trembëdhjetë	i,e trembëdhjetë
14 katërmëdhjetë	i,e katërmëdhjetë
15 pesëmbëdhjetë	i,e pesëmbëdhjetë
16 gjashtëmbëdhjetë	i,e gjashtëmbëdhjetë
17 shtatëmbëdhjetë	i,e shtatëmbëdhjetë
18 tetëmbëdhjetë	i,e tetëmbëdhjetë
19 nëntëmbëdhjetë	i,e nëntëmbëdhjetë
20 njëzet	i njëzetë



Exercise 4

Translate the phrases in parentheses into the correct form.

- 1 **Po shikoj** _____ (the small boy).
- 2 **Ata kanë** _____ (two boys).
- 3 **Unë banoj në** _____ (a new building).
- 4 **Ajo shikon** _____ (the beautiful house).
- 5 **Kam disa** _____ (new apartments).



Exercise 5

Translate the phrases in parentheses. Pay attention to the correct case.

- 1 **Ata banojnë në** _____ (the first floor).
- 2 **Ne jemi në** _____ (the third floor).
- 3 **Ky është** _____ (the fifteenth floor).
- 4 **Atje ka** _____ (five apartments) me qira.
- 5 _____ (The new apartments) **janë** _____ (unfurnished).
- 6 **Teuta po vjen nga** _____ (the first floor).



Exercise 6

Read these ads (**njoftime**) and answer the questions that follow.

- 1 **Ofrojmë apartamente për shitje në Sarandë me çmime shumë konkurruese. Apartamentet janë 200 metra nga deti. Çmimi është 650 euro për m².**
- 2 **Jap me qira për sezonin turistik një vilë me 3 kate, me 4 dhoma gjumi, 3 kuzhina, me dy ballkone të mëdha. Vila është 150 m nga plazhi. Ka afër dyqane, restorante, etj.**



Vocabulary

bosh, -e	empty
çmim, -i, -e	price
det, -i, -e	sea

dhom/ë, -a, -a	room
dhomë gjumi	bedroom
jap	to give
kat, -i, -e	floor
kontaktoj	to contact
konkurrues, -e	competitive
m ² (metra katrorë)	square metres
ofroj	to offer
pallat, -i, -e	block of flats
për shitje	for sale
preferoj	to prefer
sezon, -i, -e	season
shitje/e, -a, -e	selling, sale
për shitje	for sale
tek	at
plazh, -i, -e	beach
stadium, -i, -e	stadium
turistik, -e	touristic
vil/ë, -a, -a	villa

- 1 Çfarë kërkon klienti në njoftimin 1?
- 2 Ku janë apartamentet për shitje?
- 3 Sa është çmimi për m² (metër katror)?
- 4 Sa dhoma dhe sa ballkone ka vila në njoftimin 2?
- 5 Çfarë ka vila afër?
- 6 Me sa kate është vila?

Exercise 7



Create a dialogue between a client looking for an apartment to rent and an estate agent, using the information in Exercise 6.



Exercise 8

Describe this house using the vocabulary provided.



A CB

Vocabulary

abazh <u>ur</u> , -i, -ë	lamp
buf <u>e</u> , -ja, -	cupboard
çat <u>i</u> , -a, -	roof
garazh, -i, -e	garage
komod <u>i</u> n/ë, -a, -a	night-table
kom <u>o</u> , -ja, -	dresser
oxh <u>a</u> /k, ku, -qe	chimney
perd <u>e</u> , -ja, -e	curtain
so b /ë, -a, -a	stove
shtrat, -i, shtr <u>e</u> tër ⁵	bed

⁵ Also krevat, -i, -e.

Unit Six

Në dyqan

At the store

In this unit you will learn about:

- buying newspapers
- the pronouns **cili, cila, cilët, cilat** ‘which’
- direct object pronouns and clitics
- shopping for fruit and vegetables
- Class 2 verbs
- weights and sizes
- the use of Albanian money
- recipes



Dialogue 1



Te gazetashitësi (CD1; 45)



Erika is buying some newspapers.

- | | |
|---------------|--|
| ERIKA | Mirëmëngjes! I keni gazetat e sotme? |
| GAZETASHITËSI | Po. I kemi. Kemi gazetën “Shqip”, “Gazetën shqiptare”, gazetën “Panorama”, gazetën “Mapo”, etj. Cilën gazetë doni? |
| ERIKA | Dua gazetën “Panorama” dhe gazetën “Mapo”. |
| GAZETASHITËSI | Urdhëroni! Po ju zonjë, çfarë gazete doni? |
| ELIZA | Dua gazetën “Çelësi”. E keni? |

GAZETASHITËSI	Po e kemi. Kemi numrin e sotëm dhe numrin e kaluar. Cilin numër doni?
ELIZA	Dua numrin e sotëm.
ERIKA	Edhe për mua një gazetë “Çelësi”, ju lutem.
GAZETASHITËSI	Urdhëroni!



Vocabulary

cili	which (masc, nom)
cilin	which (masc, acc)
cilën	which (fem, acc)
gazetë/ë, -a, -a	newspaper
cilën gazetë	which newspaper (acc)
gazetashitës, -i, -	newspaper seller
i, e kaluar	last, previous
numër, -ri, -ra	number, issue
cilin numër	which issue (acc)
për mua	for me
i sotëm, e -me	today's



Language points

Cili 'which'

The indefinite interrogative adjective **cili** 'which' must agree in gender, number and case with the noun it modifies. The accusative is formed in the same way as we learned for nouns in the previous unit. **Cili** is always followed by the indefinite form of the noun:

cili → cilin	Cili djalë është ky?	Which boy is this? (nom)
	Cilin djalë po shikon?	Which boy are you seeing? (acc)
cila → cilën	Cila vajzë është kjo?	Which girl is this? (nom)
	Cilën vajzë po shikon?	Which girl are you seeing? (acc)

In the plural, nominative and accusative forms are the same:

cilët → cilët	Cilët djem janë këta?	Which boys are these? (nom)
	Cilët djem po shikon?	Which boys are you seeing? (acc)
cilat → cilat	Cilat vajza janë këto?	Which girls are these? (nom)
	Cilat vajza po shikon?	Which girls are you seeing? (acc)

The following chart summarizes the forms studied so far:

	<i>Masculine singular</i>	<i>Feminine singular</i>	<i>Masculine plural</i>	<i>Feminine plural</i>
Nominative	cili	cila	cilët	cilat
Accusative	cilin	cilën	cilët	cilat

Accusative pronouns and clitics

In Dialogue 1 you encountered the forms:

Edhe për mua një gazetë “Çelësi”, ju lutem.

For me a newspaper “Çelësi” as well, please.

I keni gazetat e sotme?

Do you have (them) today’s newspapers?

E keni?

Do you have it?

These are accusative pronouns. Pronouns come in two forms in Albanian, a strong and a weak form (the weak form is also called a clitic pronoun). The following chart shows the weak and strong forms of the different pronouns:

<i>Nominative</i>	<i>Accusative</i>	
	<i>strong</i>	<i>weak (clitic)</i>
unë	mua	më
ti	ty	të
ai	atë	e
ajo	atë	e
ne	ne	na
ju	ju	ju
ata	ata	i
ato	ato	i

The strong accusative forms of pronouns are used:

- after the prepositions **për** ‘for’, **pa** ‘without’, **me** ‘with’, **në** ‘in, at’, **mbi** ‘on’, **nën** ‘under’.

Ata flasin për mua.

They speak about me.

Ata shkojnë në shkollë pa mua.

They go to school without me.

Mbi ne banon xhaxhai.

Above us lives (our) uncle.

- to emphasize the direct object, which is typically placed at the front of the sentence. The clitic form must co-occur with the emphatic form.

Mua më **besojnë miqtë.**

The friends trust ME.

While the weak form must always stay next to the verb, the strong (or emphatic) form may float around.

Më **besojnë** mua **miqtë.**

The friends trust ME.

Më **besojnë miqtë** mua.

The friends trust ME.

The weak form is used to replace the direct object when the direct object is understood from context.

Po, e kam unë.

Yes, I have it.

Po, i kam unë.

Yes, I have them.

In spoken Albanian, definite direct objects may co-occur with the accusative clitic. In Standard Albanian these forms are mostly used with definite nouns.

- I **keni** gazetat e sotme? Do you have (them) today's newspapers?

Exercise 1



Use the short forms **e** or **i** of the personal pronouns.

- 1 _____ **keni** gazetën “Panorama”?
- 2 **Po**, _____ **kemi** gazetat e sotme.
- 3 **Ata** _____ **shikojnë** shokët.
- 4 _____ **doni** gazetën “Shqip”?
- 5 _____ **duam**.

Exercise 2



Use the correct form of the pronouns in parentheses.

- 1 **Vajzat po flasin me** _____ (him).
- 2 **Djali bisedon për** _____ (us).
- 3 **Ajo rri në shtëpi pa** _____ (them, masc).
- 4 **Unë po mendoj** (to think) **për** _____ (you, informal).
- 5 **Ai po blen** (to buy) **një gazetë për** _____ (me).

Exercise 3



Translate the expressions in parentheses. Pay attention to the form of the adjective.

- 1 **Nuk e kemi** _____ (today's newspaper).
- 2 **Dua** _____ (the previous issue).
- 3 **Ata po flasin për** _____ (the good student, masc).
- 4 **Nuk i kemi** _____ (today's newspapers).
- 5 **Po bisedoj me** _____ (the good students, fem).

Exercise 4



Translate the following sentences.

- 1 Do you have today's newspaper?
- 2 I want the newspaper 'Mapo'.
- 3 Do you have it?
- 4 He has the last issue.
- 5 Which newspaper would you like?



Dialogue 2



Në dyqan (CD1; 47)

Sofia is shopping for some fruit and vegetables.

- SOFIA Mirëdita. Dua dy kilogramë patate. A keni?
 SHITËSJA Po. Kemi patate të reja. Janë shumë të mira.
 SOFIA Po speca, a keni?
 SHITËSJA Kemi speca të kuq dhe speca jeshilë. Sa kilogramë doni?
 SOFIA Po marr dy kilogramë speca jeshilë dhe një kilogram sallatë jeshile. Si është sallata jeshile?
 SHITËSJA Është shumë e freskët.
 SOFIA Më falni, po kërkoj për domate, por nuk po i shoh.
 SHITËSJA Domatet janë atje në fund. Kemi domate shumë të mira. Si i doni?
 SOFIA I dua për sallatë. Po marr dhe një kilogram qepë. Ah, paskeni dhe patëllxhanë! Dy kilogramë patëllxhanë, ju lutem, dhe dhjetë kokrra vezë.
 SHITËSJA Urdhëroni!
 SOFIA Sa kushtojnë të gjitha?
 SHITËSJA 1000 lekë.



Vocabulary

domat <u>e</u> , -ja, -e	tomato
i,e freskët	fresh
në fund	at the end
të gjitha	all together
jeshil , -e	green
kërkoj (për)	to search, to look for
kilogram , -i, -ë	kilogram
kok/ërr , -rra, -rra	piece
marr	to take
paskeni	you have! (admirative form)
patat <u>e</u> , -ja, -e	potato

patëllxhan , -i, -ë	aubergine, eggplant
qep/ë , -a, -ë	onion
Sa kushtojnë të gjitha?	How much for everything?
sallat/ë , -a, -a	salad
sallatë jeshile	green salad
spec , -i, -a	pepper
specat të kuq	red peppers
specat jeshilë	green peppers
shoh	to see, to watch
vez/ë , -a, -ë	egg

Additional vocabulary

Shopping

bëj pazar	to shop
blej	to buy
dyqan , -i, -e	store
markat/ë , -a, -a	market
supermarkat/ë , -a, -a	supermarket
shes	to sell

Language points



Present tense indicative of Class 2 verbs

In this unit, you will learn how to conjugate Class 2 verbs, i.e. verbs that end in a consonant.

	hap 'to open'	mbyll 'to close'
unë	hap	mbyll
ti	hap	mbyll
ai, ajo	hap	mbyll
ne	hapim	mbyllim
ju	hapni	mbyllni
ata, ato	hapin	mbyllin

In Unit 2 you learned how to conjugate the verb **flas** ‘to speak’. This is also a Class 2 verb, but notice the vowel changes that this verb undergoes in the forms for **ti**, **ai/ajo** and **ju**. The same pattern of vowel change (**a/e/i**) is observed with the verb **dal** ‘to go out’.

	flas ‘to speak’	dal ‘to go out’
unë	flas	dal
ti	flet	del
ai, ajo	flet	del
ne	flasim	dalim
ju	flisni	dilni
ata, ato	flasin	dalin

Other Class 2 verbs undergo only two vowel changes (**a/e**).

	marr ‘to take’	jap ‘to give’
unë	marr	jap
ti	merr	jep
ai, ajo	merr	jep
ne	marrim	japim
ju	merrni	jepni
ata, ato	marrin	japin

In Dialogue 2, you encountered another Class 2 verb, **shoh** ‘to see’, where you can observe three vowel changes (**o/e/i**) as well. Similar to **shoh** is the verb **njoh** ‘to know’.

	shoh ‘to see, to watch’	njoh ‘to know’
unë	shoh	njoh
ti	sheh	njeh
ai, ajo	sheh	njeh
ne	shohim	njohim
ju	shihni	njihni
ata, ato	shohin	njohin

Similar to **flas** ‘to speak’ are the verbs **pres** ‘to wait’ and **shes** ‘to sell’ in that the second and third person singular end in **-t** rather than in **-s**.

	flas ‘to speak’	pres ‘to wait’	shes ‘to sell’
unë	flas	pres	shes
ti	flet	pret	shet
ai, ajo	flet	pret	shet
ne	flasim	presim	shesim
ju	flisni	prisni	shisni
ata, ato	flasin	presin	shesin

Some Class 2 verbs that end in **-s** can take two forms in the **unë**, **ne** and **ata/ato** forms. Both forms are interchangeable.

	përgatis ‘to prepare’	mas ‘to weigh’
unë	përgatis/përgatit	mas/mat
ti	përgatit	mat
ai, ajo	përgatit	mat
ne	përgatisim/përgatitim	masim/matim
ju	përgatisni	matni
ata, ato	përgatisin/përgatitin	masin/matin

A very common (and quite irregular) Class 2 verb is the verb **them** ‘to say’.

	them ‘to say’
unë	them
ti	thua
ai, ajo	thotë
ne	themi
ju	thoni
ata, ato	thonë

Weights, Part I: Fruits and vegetables

In Albania, as in other European countries, the metric system is used. Fruits and vegetables are sold in kilograms: **gjysmë kilogrami** 'half a kilo', **çerek kilogrami** 'quarter of a kilo'. In the spoken language you will also hear **kile/kilo** instead of **kilogram**, e.g. **gjysëm kile domate**, **çerek kile domate**.

Dua një kilogram domate.

I would like one kilo of tomatoes.

Dua dy kilogramë domate.

I would like two kilos of tomatoes.

You can buy also in pieces.

Dua një kokërr domate.

I would like one tomato.

Dua dy kokrra domate.

I would like two tomatoes.

Eggs are sold in **kokërr/kokrra**.

Dua një kokërr vezë.

I would like one egg.

Dua dy kokrra vezë.

I would like two eggs.

Notice that we use the plural form of the noun if the noun can be counted. If the noun cannot be counted (we say that it is a mass noun), then we use the singular form.

Dua një kilogram sheqer.

I would like a kilo of sugar.

The use of Albanian money

Albania uses the Albanian currency **lek**. The plural is **lekë**.

Caution!

In 1964, the lek was devalued: a zero was dropped from the value of the currency (or from each bill) so that 100 lekë became 10 lekë. Nearly 50 years after the change, Albanians still quote the prices in old lekë, even though officially the prices are used in the new system. To make sure that the price you have been

quoted is correct, you should ask: **lekë të reja apo lekë të vjetra?**
‘new or old lekë?’

Exercise 5



Complete the following sentences with the correct forms of the verbs in the present indicative.

- 1 **Ai po** _____ (shoh) një shok.
- 2 **Vajza po** _____ (marr) një kilogram domate.
- 3 **Ti** _____ (përgatis) një darkë (dinner) të mirë.
- 4 **Çfarë po** _____ (them, ti)?
- 5 **Kush po** _____ (hap) dritaren?

Exercise 6



Complete the following sentences with the correct form of the words.

- 1 **Kemi** _____ (red peppers).
- 2 **Po marr** _____ (two kilos of green peppers).
- 3 **Kemi domate** _____ (very good).
- 4 **Dua** _____ (three kilos of aubergines).
- 5 **Keni** _____ (eggs)? **Dua** _____
(ten eggs).

Exercise 7



Translate the following.

- 1 Do you have potatoes?
- 2 How many kilos of tomatoes would you like?
- 3 Is the green salad fresh?
- 4 One kilo of tomatoes costs 80 lekë.
- 5 I also want one kilo of onions.



Exercise 8


Answer the following questions based on the reading below:

- 1 Çfarë është ballokumja?
- 2 Si e përgatisim ballokumen?
- 3 Sa kokrra vezë duhen (are needed)?
- 4 Sa gjalpë?
- 5 Për sa minuta e pjekim?
- 6 Në çfarë temperature e pjekim?



(CD1; 49, 50)

Ballokumja



Ballokumja është një ëmbëlsirë karakteristike për Elbasanin. Është sinonim për Ditën e Verës (14 Mars). Ballokumen e përgatisim me: gjalpë të freskët (500 gramë), sheqer (1 kg), vezë (8 kokrra), miell misri (1 kg).

Gatimi

Tresim gjalpin. Rrahim gjalpin bashkë me sheqerin dhe shtojmë vezët një nga një. Më pas shtojmë miellin dhe vazhdojmë përzierjen. E lëmë brumin 15 minuta në qetësi. Më pas hedhim pak miell në tepsi dhe vëmë ballokumet. I pjekim për 40 minuta në temperaturën 170°C.

Vocabulary



bashkë me	together with
brum/ë, -i	dough
Dita e Verës	Spring Day (literally: Summer Day)
ëmbëlsir/ë, -a, -a	sweet
gatim, -i, -e	cooking
gjalp/ë, -i	butter
hedh	to throw, add
lë	to leave
miell	flour
miell misri	corn flour
mis/ër, -ri, -ra	corn
një nga një	one by one
pas	after
më pas	afterward
përzierj/e, -a, -e	mixture
pjek	to bake
qetësi, -a, -	tranquillity, serenity
në qetësi	at rest
rrah	to beat
sinonim, -i, -e	synonym
sheqer, -i	sugar
shtoj	to add
temperatur/ë, -a, -a	temperature
tepsi, -a, -	flat pan
tres	to dissolve
vazhdoj	to continue
vë	to put



Exercise 9

Translate the following recipe.

Tavë dheu

Përbërësit për 4 persona:

- 300g gjizë
- 250g mish ose mëlçi
- 3 domate
- 2 spec
- 150g vaj ulliri
- 3 thelbinj hudhra
- spec djegës
- 2 kokrra qepë
- kripë

Përgatitja:

Marrim një tigan dhe hedhim vajin, mishin, qepën dhe pastaj i përziejme. Më pas hedhim domatet e grira, hudhrat, specin djegës, i përziejme dhe i ziejme për 20 minuta. Pastaj hedhim edhe gjizën dhe e ziejme për pak minuta.



Vocabulary

djegës, -e	hot, burning
i,e grirë	minced/ground
gjiz/ë, -a	cottage cheese
hudh/ër, -ra, -ra	garlic
krip/ë, -a, -ëra	salt
mëlçi, -a, -	liver
mish, -i, -ra	meat
pastaj	then, later, afterward
përbërës, -i, -	ingredient
përgatitj/e, -a, -e	preparation

përziej	to mix
qep/ë, -a, -ë	onion
spec djegës	hot pepper
tigan, -i, -ë	frying pan
thelb, -i, -inj	clove
vaj, -i	oil
vaj ulliri	olive oil
ziej	to boil

Culture point



The most important public holidays in Albania are:

New Year – Viti i Ri (January 1st and 2nd): This is a major celebration for all Albanians. It is a period of the year when Albanians get together with their family and friends who live abroad. A typical dish for New Year's Eve is turkey (**gjeldeti**).

March 14, Spring Day – Dita e Verës: This is a celebration that marks the beginning of spring. A typical dessert on this day is **ballokume**.

March 22, Sultan Novrus – Dita e Sulltan Novruzit: This is the celebration of the beginning of the year by the Bektashi sect in Albania. A typical dessert on this day is **hashure** 'wheat pudding'.

May 1, Workers' Day – Dita e Punëtorëve: This is 'International Workers' Day' and it commemorates the 1886 Haymarket Massacre in Chicago, USA, where police fired against workers during a general strike. It is an important official holiday in many communist countries, and celebrations typically include parades by the armed forces and workers. Afraid that May 1 might be used as a day to commemorate the Chicago riots, the then-president of the United States, Grover Cleveland, accepted the proposal by some New York workers' groups to celebrate Workers' Day on September 1. Since 1887 that is when Workers' Day is celebrated in the United States and in Canada.

October 19, Mother Teresa's Beatification Day – Dita e Lumturimit të Nënë Terezës: Mother Theresa of Calcutta is of Albanian origin. Her real name was Agnes Gonxhe Bojaxhiu. Her mother and sister lived

in Albania. On October 19, 2003, Pope John Paul II beatified Mother Theresa. Since then, October 19 has been a holiday in Albania.

November 28, Independence Day – Dita e Pavarësisë: Albania declared its independence from the Ottoman Empire on November 28, 1912, after 500 years of Ottoman rule.

November 29, Liberation Day – Dita e Çlirimit: On November 29, Albania commemorates its liberation from the fascist occupation on that date in 1944.

December 8, Youth Day – Dita e Rinisë: This date has been a holiday since 2010. It commemorates the student demonstrations against the Communist regime.

The other public holidays in Albania are: Catholic and Orthodox Easter, Christmas (December 25), **Bajrami i Vogël** (Eid El Fitter) and **Bajrami i Madh/Kurban Bajrami** (Eid al-Adha).

Unit Seven

Në restorant

At the restaurant

In this unit you will learn about:

- common phrases used for grocery shopping
- the attributive ablative case
- weights: dairy products and liquids
- phrases used to order desserts at a pastry shop
- the comparative form of adjectives and adverbs
- phrases used to order in a restaurant
- how to express possession for singular possessors



Dialogue 1



Në minimarket (CD1; 51)



Sofia is shopping in a small store (**minimarket**) in Tirana.

SHITËSJA Mirëdita, zonjë. Urdhëroni!

SOFIA Mirëdita! Dua dy kilogramë djathë. Keni djathë vendi?

SHITËSJA Po, kemi djathë vendi shumë të mirë. Doni djathë të bardhë apo djathë kaçkavall?

SOFIA Dua dy kilogramë djathë të bardhë dhe dy pako gjalpë, ju lutem. Po vaj ulliri, a mbani?

SHITËSJA Po.

- SOFIA Dua edhe gjysmë¹ litri vaj ulliri. Po marr dhe një litër² vaj vegjetal, një bukë dhe makarona. Çfarë makaronash keni?
- SHITËSJA Kemi makarona italiane.
- SOFIA Shumë mirë. Po marr dy pako makarona dhe një pako oriz.
- SHITËSJA Doni ndonjë gjë tjetër?
- SOFIA. Një shishe qumësht dhe dy kuti me kos me fruta. Po reçel, keni?
- SHITËSJA Po, kemi reçel fiku, reçel pjeshke, reçel portokalli. Çfarë reçeli doni?
- SOFIA Dua një çerek kilogrami³ reçel pjeshke.

A CB

Vocabulary

blëj	to buy
bukë/ë, -a, -ëra	bread
djathë/ë, -i, -ra	cheese
djathë i bardhë	feta cheese (literally: white cheese)
djathë kaçkavall	fat cheese
djathë vendi	local cheese
fij/k, -ku, -q	fig
gjalpë/ë, -i	butter
gjalpë me pako	a pack of butter
kos, -i	yoghurt
kuti, -a, -	box
lek, -u, -ë	Albanian currency
lekë të reja	new currency
lekë të vjetra	old currency
litër/ër, -ri, -ra	litre
gjysmë litri	half a litre
makarona, -t	pasta
makaronash	pasta (ablative case)

¹ In colloquial language, you will hear **gjysëm** instead of **gjysmë**.

² In colloquial language, you will more often hear **një kilogram vaj** instead of **një litër vaj**.

³ In colloquial language, you will hear **(një) çerek kile**.

mbaj	to carry, keep, have
oriz, -i	rice
pako, -ja, -	pack, package
pjeshk/ë, -a, -ë	peach
portoka/ll, -lli, -j	orange
qumësht, -i	milk
qumësht lope	cow milk
qumësht me kuti	carton of milk
reçel, -i	jam
reçel fiku	fig jam
reçel pjeshke	peach jam
reçel portokalli	marmalade
shish/e, -ja, -e	bottle
ulli, -ri, -nj	olive
vaj	oil
vaj ulliri	olive oil
vaj vegjetal	vegetable oil
i vjet/ër, e -ra	old

Language points



Attributive ablative case

In Dialogue 1 you found the following structures:

djathë vendi	local cheese
vaj ulliri	olive oil
gjysmë litri	half a litre

In these constructions there are two nouns, and the second noun modifies the first one. The first noun is always indefinite and the second noun typically appears in the attributive ablative case. To form the ablative case, simply follow these rules:

For singular masculine nouns, add **-i** or **-u**.

reçel portokall-i	marmalade
reçel fik-u	fig jam

For singular feminine nouns, replace the **-ë** ending with **-e**, or add **-je** if the noun ends in a stressed vowel, except **-i**. If it ends in a stressed **-i**, add **-e**.

mish lop-e	beef
mish dele-je	lamb
reçel qersh-i-e	cherry jam

To form a plural attributive, simply add **-sh** to the plural indefinite form.

Çfarë makaronash keni?	What kind of pasta (pl) do you have?
-------------------------------	--------------------------------------

Uses of the attributive ablative case

The attributive ablative case is used:

- (a) when a noun modifies an indefinite noun⁴

qumësht lope	cow milk
---------------------	----------

- (b) to indicate the material composition of an indefinite noun

reçel pjeshke	peach jam
----------------------	-----------

- (c) with certain measure phrases

një çerek kilogrami	quarter of a kilo
gjysmë litri	half a litre

However, notice that we use the indefinite form with the following measure expressions:

dy pako gjalpë	two packs of butter
një shishe qumësht	a bottle of milk
një litër vaj	a litre of oil
një kilogram djathë	a kilo of cheese

⁴ If the first noun is definite, then the genitive rather than attributive ablative case must be used:

qumësht lope	cow milk
qumështi i lopës	the cow milk

We will study these constructions in Unit 13.

(d) after the question word **çfarë** 'what'⁵

Çfarë reçeli **keni**? What kind of jam do you have?

Weights, Part II: Dairy products and liquids

As mentioned in Unit 6, Albania uses the metric system. For liquids we use the following measures:

- **litër, litra**

një litër qumësht	a litre of milk
dy litra qumësht	two litres of milk

In the colloquial language, **litër** is not used very frequently. As for products that you buy by units of weight, most people use **kilogram** or **kilo**. Don't be surprised to hear:

një kilogram vaj a kilogram of oil

or even:

një kile vaj a kilogram of oil

As you saw in Dialogue 1, for dairy products you can also use:

- **shishe** 'bottle' or **kuti** 'carton' (for milk and yoghurt)

një shishe kos	a bottle of yoghurt
një shishe qumësht	a bottle of milk
një kuti qumësht	a carton of milk
një kuti kos	a carton of yoghurt

- **pako** 'pack'

një pako gjalpë a pack of butter

Notice that in all the units discussed above, you use the indefinite form of the product you are measuring.

⁵ Remember that the question word **ç** 'what' is interchangeable with **çfarë** 'what'. However, while **çfarë** takes the indefinite attributive ablative case, **ç** takes an indefinite form:

çfarë profesioni	ç profesion	what profession
çfarë kombësie	ç kombësi	what nationality



Exercise 1

Complete the following sentences with the attributive ablative form of the nouns indicated.

- 1 Unë dua gjysmë _____ (kilogram) djathë.
- 2 Ata marrin qumësht _____ (lopë).
- 3 Blejmë reçel _____ (portokall).
- 4 Çfarë _____ (profesion) keni?
- 5 Ata duan vaj _____ (ulli).
- 6 A keni djathë _____ (vend)?
- 7 Doni reçel _____ (pjeshkë)?
- 8 Çfarë _____ (makarona) keni?
- 9 Çfarë _____ (djathë) doni?
- 10 Ai blen një çerek _____ (litër) vaj.



Exercise 2

Translate the phrases in parentheses.

- 1 Keni _____ (local cheese)?
- 2 Dua _____ (two kilos of cheese).
- 3 A mbani _____ (olive oil)?
- 4 Çfarë _____ (pasta) keni?
- 5 Dua _____ (half a litre of olive oil).
- 6 A keni _____ (cow milk)?
- 7 Duam _____ (a bottle of milk) dhe _____ (quarter of a kilo of fig jam).
- 8 Kemi _____ (fig jam), _____ (peach jam), dhe _____ (marmalade).



Exercise 3

Translate the following.

- 1 Do you have olive oil?
- 2 I would like (some) butter.
- 3 I would like half a litre of olive oil.
- 4 We have very good feta cheese.
- 5 What kind of jam would you like?

Dialogue 2



Në pastiçeri (CD1; 53)



Ema and Drena are at the pastry shop.

- KAMARIERI Urdhëroni! Çfarë dëshironi?
- EMA Çfarë ëmbëlsirash keni?
- KAMARIERI Kemi akullore, bakllava, krem karamel etj.
- EMA Unë dua akullore. Çfarë akulloresh keni?
- KAMARIERI Kemi akullore me vanilje, me çokollatë, me luleshtrydhe, me limon, me qershi.
- EMA Cila është më e mirë? Akullorja me çokollatë apo me luleshtrydhe?
- KAMARIERI Varet nga shija juaj, zonjë.
- EMA Mirë. Po mar një akullore me çokollatë, se më pëlqen më shumë.
- DRENA Keni torta?
- KAMARIERI Po. Kemi torta shumë të mira. Kemi tortë me fruta, tortë me gështenjë, tortë me arra.
- DRENA Mirë, një tortë⁶ me fruta, ju lutem.

Vocabulary



akullor/e, -ja, -e	ice cream
apo	or (used mostly in interrogative sentences)
arr/ë, -a, -a	walnut
bakllava, -ja, -	baklava
çokollat/ë, -a, -a	chocolate
ëmbëlsir/ë, -a, -a	dessert
gështenj/ë, -a, -a	chestnut
krem, -i, -ra	cream
krem karamel	custard
kurse	whereas

⁶ In this case **një tortë me fruta** means a piece (**një copë**) of fruit cake.

limon , -i, -a	lemon
luleshtrydh/e , -ja, -e	strawberry
më e mirë	better
më shumë	more
pastiçeri , -a, -	confectionery
qersh i, -a, -	cherry
se	because
shij/e , -a, -e	taste
shija juaj	your taste
tort/ë , -a, -a	cake
vanilj/e , -a	vanilla
varet nga	it depends on



Language points

Comparative adjectives

In Albanian, comparative adjectives are formed by adding the adverb **më** in front of the adjective.

Ky djalë është më trim. This boy is braver.

If the adjective includes an adjectival article, the comparative **më** must precede both the adjectival article and the adjective.

Çaji me limon është më i mirë.

The lemon tea is better.

Akullorja me çokollatë është më e mirë.

The chocolate ice cream is better.

Kamarierët janë më të mirë atje.

The waiters are better there.

Tortat me fruta janë më të mira.

The fruit cakes are better.

In the examples above, one of the elements being compared is understood from context. When the two elements being compared are mentioned, use **se** or **sesa** 'than' after the comparative adjective.

Çaji me limon është më i mirë se çaji me kamomil.

(The) lemon tea is better than (the) chamomile tea.

Akullorja me çokollatë është më e mirë se akullorja me luleshtrydhe.

(The) chocolate ice cream is better than (the) strawberry ice cream.

Kamarierët janë më të mirë atje sesa këtu.

(The) waiters are better there than here.

Tortat me fruta janë më të mira se tortat me çokollatë.

(The) fruit cakes are better than (the) chocolate cakes.

To express 'less (than)' use **më pak . . . se(sa)**.

Vajza është më pak e shqetësuar se(sa)⁷ djali.

The girl is less worried than the boy.

Comparative adverbs

Adverbs follow the same pattern as adjectives when you want to compare them.

Akullorja me çokollatë më pëlqen më shumë.

I like the chocolate ice cream more.

Kamarierët punojnë më mirë atje se(sa) këtu.

(The) waiters work better there than here.

Possessive adjectives, Part I: Nominative singular possessee

Possessive adjectives agree in number, gender and case with the nouns they modify. The following are the possessive adjectives for definite nominative nouns in the singular:

djali	im	vajza	ime	my son/daughter
djali	yt	vajza	jote	your son/daughter
djali	i tij	vajza	e tij	his son/daughter

⁷ **Se** and **sesa** can be used interchangeably.

djali	i saj	vajza	e saj	her son/daughter
djali	ynë	vajza	jonë	our son/daughter
djali	juaj	vajza	juaj	your son/daughter
djali	i tyre	vajza	e tyre	their son/daughter



Exercise 4

Translate the following comparative phrases in parentheses.

- 1 **Vajza është** më e vogël se (smaller than) **djali**.
- 2 **Studentët mësojnë** _____ (more than) **nxënësit**.
- 3 **Vajzat flasin** _____ (more beautifully than) **djemtë**.
- 4 **Dhoma teke është** _____ (bigger than) **dhoma dopio**.
- 5 **Vajzat flasin** _____ (worse than) **djemtë**.
- 6 **Qilimi është** _____ (more expensive than) **unaza**.
- 7 **Ajo ha** _____ (more) **akullore se torta**.
- 8 **Shtëpitë në Durrës janë** _____ (cheaper than) **në Tiranë**.
- 9 **Filmi i ri është** _____ (more beautiful).
- 10 **Ti punon** _____ (better than) **unë**.



Exercise 5

Use the possessive pronouns in the correct form.

- 1 Djali im _____ (My son) **është i vogël**.
- 2 _____ (My house) **është e vogël**.
- 3 _____ (Your, formal, apartment) **është i bukur**.
- 4 _____ (Their student, fem) **është më e mirë sesa** _____ (their student, masc).
- 5 _____ (Your, informal, apartment) **është më i mirë**.
- 6 _____ (His student) **është i mirë**.
- 7 _____ (Her book) **është më i mirë sesa** _____ (my book).
- 8 _____ (Our teacher, fem) **është nga Shqipëria kurse** _____ (their teacher, fem, referring to some boys) **është nga Kosova**.

- 9 _____ (Our father) **është më i ri sesa** _____
(our mother).
- 10 _____ (Our lesson) **është më i vështirë se**
_____ (your, pl, lesson).
- 11 _____ (Your, informal, sister) **është më e**
zgjuar sesa _____ (your brother).

Dialogue 3



Në restorant (CD1; 54)



A group of friends are ordering food at a restaurant.

- ARDIANI Mirëdita! Çfarë keni sot në meny?⁸
- KAMARIERI Sot kemi supë me perime, sallata të ndryshme, gjellë tradicionale etj.
- ARDIANI Unë dua një supë me perime dhe një biftek me patate.
- ERA Unë po marr një supë me domate. Si thoni, a marrim dhe një sallatë me perime të skarës?
- ANDREA E marrim. Më falni, çfarë gjellësh tradicionale keni?
- KAMARIERI Kemi tavë kosi, specia të mbushur, patëllxhanë të mbushur, byrek.
- ANDREA Po marr një tavë kosi dhe patëllxhanë të mbushur. Kam shumë uri.
- BESA A keni gjellë pa mish?
